



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1862 Prot.

Tiranë, më 01.08.2025

VENDIM QARKULLUES

Nr. 43 Datë 01.08 2025

**“PËR
MIRATIMIN E PAGESËS SË ORËVE JASHTË ORARIT ZYRTAR TË PUNËS
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 49, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", neni 90, pika 1, pika 2, neni 91, pika 3, të VKM Nr. 568, datë 6.10.2021 "Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes Kreu II. "Kohëzgjatja e punës dhe orët shtesë" pikat 7, 10, 13, të Vendimit të Rektorit nr. 144 datë 01.07.2025 "Për organizimin e shkollës sezonale 2025 "Autizmi sporti dhe përfshirja: si një sfidë për arsimin dhe shoqërinë", të shkresës së Rektorit, nr. 1708 prot., datë 09.07.2025 "Për angazhimin e shoferit të UST-së jashtë orarit të punës", të shkresës nr. 1708/1., datë 18.07.2025, "Përcjellje e tabelës për realizimin e orëve jashtë orarit për Z. Renado Topi", të shkresës së Rektorit nr. 1658., datë 01.07.2025 "Për angazhimin jashtë orarit të punës për dy punonjëset e Sektorit të Arkiv /Protokollit për rregjistrimin e studentëve të Ciklit të tretë "Doktoratë" në FSHL dhe FVFR", në shkresën e Rektorit nr. 1658., datë 09.07.2025 "Për angazhimin jashtë orarit të punës për dy punonjëset e Sektorit Arkiv/Protokoll", të shkresës së Rektorit nr. 1658/2., datë 23.07.2025 "Përcjellje e tabelave për realizimin e orëve jashtë orarit të punës për dy punonjëset e Sektorit të Arkiv/Protokollit, për arsye të rregjistrimit të kandidatëve për Drejtues të Njësive Kryesore pranë FSHL", të shkresës së nr. 1658/3., datë 23.07.2025 "Përcjellje e tabelave për realizimin e orëve jashtë orarit të punës për dy punonjëset e Sektorit të Arkiv/Protokollit", në Relacionin nr 1834 datë 24.07.2025 "Mbi miratimin e pagesës së orëve jashtë orarit zyrtar të punës, Bordi i Administrimit me Vendim Qarkullues të datës 01.08.2025,

V E N D O S I :

1. Miratimin e pagesës së orëve jashtë orarit zyrtar të punës, të stafit administrativ "Shofer" në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse pranë Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse si dhe orët e realizuara nga punonjëset e Sektorit të Arkiv/Protokollit në UST, tabelat bashkëlidhur ;

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtoria e Financës dhe Buxheti, të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur COBANI

